

**KSENOFON KRISAFI****LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE FAKTORI  
NDËRKOMBËTAR\***

Marrëdhëniet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me faktorin ndërkombëtar përbëjnë një ndër kapitujt e parë dhe mjaft interesantë të historisë diplomatike të çështjes shqiptare.

Ndërhyrjet energjike të drejtuesve të saj pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha, për një periudhë më se trevjeçare, përveç se do të kërkonin rrugëdalje imediate për situatat e vështira që kalonte Shqipëria e asaj kohe, do të shtronin për herë të parë për zgjidhje ndërkombëtare çështjen shqiptare në tërësinë e vet. Në këtë pikëpamje Lidhja e Prizrenit mund të konsiderohet si kurorëzimi i përpjekjeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për t'ia imponuar atë institucionalisht faktorit ndërkombëtar, diplomacisë evropiane, në të gjithë spektrin e vet, me peshën dhe rëndësinë që kishte marrë, përkundër trajtimit në rolin e kushinetës për amortizimin e fërkimeve politike ndërmjet Fuqive apo fqinjëve.

Shqipëria e u gjend e implikuar në raporte të drejtpërdrejta apo të tërthorta me protagonistët e zgjidhjes së Krizës Lindore, si dhe me fqinjët. Ajo u bë pjesë e diskutimeve në forumet e diplomacisë së kohës dhe zinte faqe të tëra në raportet diplomatike që iu përcilleshin nga Ballkani kancelarive evropiane. Emri i saj u përmend në diskutime në Kongresin e Berlinit dhe në forume të tjera bilaterale e multilaterale, por thjesht si element ekuilibri e stabiliteti për të tjerët.

Çështja e kufijve dhe statusi i saj politik shfaqeshin kohë pas kohe në rendin e ditës. Projektet e shteteve që po krijoheshin mbështeteshin edhe mbi copëtimin e territoreve shqiptare dhe zhdukjen e saj nga harta politike e kohës.

Çështja shqiptare, qysh në trajtimin e parë zyrtar do të ballafaqohej me dy qëndrime të kundërta, që do ta shoqëronin gjatë. Njëri ishte pozicioni nihilist i Rusisë, i ngritur mbi shpërfilljen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Tjetri ishte ai i Austro-Hungarisë, me të cilën bashkohej hera-herës edhe Italia e Franca. Të nisura nga interesat e tyre, ato avanconin projekte të ndryshme që

---

\* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare "Shqiptarët përballë sfidave të Bashkimit dhe të Lirisë", organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 13 qershor 2008.

parashikonin ngandonjëherë edhe idenë e vagullt të krijimit të një formacioni politik shqiptar.

Gjatë diskutimeve në Kongresin e Berlinit, Austro-Hungaria do të kufizohej në sanksionimin e një statusi të veçantë për krahinën e Mirditës. Franca lëkundej ngandonjëherë drejt idesë së një Shqipërie autonome, por që të ishte e dobishme për Greqinë, klienten e saj ballkanike. Italia, e interesuar për ndikimin në bregun e përtejme të Adriatikut, në momente të caktuara ishte shprehur gjithashtu për “krijimin e një Shqipërie të pavarur ose së paku autonome”, duke synuar të pengonte shtrirjen e Austrisë dhe një zmadhim të theksuar të Greqisë. Gjermania kishte si lajtmotiv qëndrimin e Bismarkut, i cili mohonte krejt ekzistencën e kombësisë shqiptare. Qeveria cariste prezantohej në rolin e protektoratit të kultit e të racës për sllavët e Ballkanit.

Nuk ishte e vështirë të dallohej se në emër të një solidariteti fals me “vëllezërit sllavë” fshihej një komponente e rëndësishme e politikës ekspansioniste tradicionale ruse, e cila e përplasi për dhjetëra vjet me perandorinë osmane dhe me fuqi të tjera evropiane.

Me pretekste të maskuara keq, por me synime të qarta për zgjerimin e influencës së saj sllavo-ortodokse, Moska tentonte me çdo kusht daljen në ujërat e ngrohta të Mesdheut, nëpërmjet Adriatikut dhe Jonit, krahas Detit të Zi dhe Egjeut. Në këtë mënyrë iu hapej horizonte edhe ambicieve shtetmëdha të të mbrojturve të saj, bullgarëve, serbëve, malazezëve e grekëve, në kurriz të shqiptarëve, të cilët përfshiheshin lehtësisht në të gjitha skemat zgjeruese të shteteve të tjera të gadishullit.

Traktati i Shën Stefanit dhe më pas Traktati i Berlinit nuk linin pa kënaqur kërkesat e Greqisë, Serbisë e Malit të Zi. Ishte kjo një përkëdhelje e ëndrrave për ringjalljen e fosileve të perandorive të tyre mesjetare të perënduara.

Pikërisht me kundërshtimin e vendosur të projekteve antishqiptare dhe me përpjekjet për të sensibilizuar pjesëmarrësit në Kongresin e Berlinit rreth ekzistencës së çështjes së pazgjidhur shqiptare, do të inauguroheshin veprimtaritë e para ndërkombëtare të Lidhjes. Për t'i bërë ballë situatave të vështira brenda dhe jashtë vendit si dhe për të dhënë prova të aftësive politike, organizuese e shtetformuese të shqiptarëve, të mohuara sistematikisht nga të tjerët, Lidhja e Prizrenit filloi ndërtimin e strukturave organizative, administrative e territoriale me profil të qartë politik e shtetëror. Zhvillimet patën progres të ndjeshëm, aq sa Lidhja shumë shpejt do të shihej si “shtet brenda shtetit”, siç shprehej aso kohe konsulli grek në Shkodër, i cili shpjegonte se tashmë në Prizren ishte formuar një shtet i përkohshëm.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit përpiqej të afirmonte tipare të subjektit të së drejtës ndërkombëtare dhe të imponohej me synimin e sigurimit të asaj që në terminologjinë juridike quhet njohja ndërkombëtare. Por, skena evropiane e asaj kohe ishte relativisht e ngushtë. Në të debutonin fare pak shtete “të qytetëruara”, kryesisht kristiane, me personalitet juridiko-ndërkombëtar.

Shqipëria përpiquej energjikisht për t'u futur në këtë klub të mbyllur shtetesh, duke rendur në çdo drejtim, por arritjet ishin përgjithësisht dekurajuese. Heraherës, siç u tha, shfaqeshin në krah të saj pjesëtarë të Koncertit Europian të Fuqive, por vetëm përkohësisht dhe jo me aksione mbështetëse solide e të qëndrueshme.

Lidhja e Prizrenit trokiti fillimisht në Portën e Lartë. Stambolli fillimisht ishte inkurajues. Shpresonte se nëpërmjet Lidhjes mund të arrinte më lehtë qëllimet në Ballkan. Më vonë, indiferenca e tij dhe zhvillimet në Shqipëri bënë që lidhjet institucionale e administrative ndërmjet Portës dhe krahinave të saj shqiptare të zbeheshin ndjeshëm. Në pikëpamje juridiko-ndërkombëtare mund të kualifikoheshin më tepër si lidhje partneriteti se sa si raporte midis qendrës dhe bazës, midis pjesës dhe të tërës.

Kur Lidhja e Prizrenit u angazhua në veprimtari të gjithanshme shtetformuese, për ta shkëputur Shqipërinë nga trangu perandorak, Porta e Lartë, që deri pak kohë më parë ishte ngurtësuar në një qëndrim shpërfillës, iu rikthye qëndrimeve të dikurshme. Ajo e mbyti në gjak Lidhjen dhe burgosi e syrgjynosi në humbëtitat aziatike drejtuesit e saj. Qëndrimi inert i Stambollit ishte një ndër arsyet që do ta shtynte Lidhjen të hynte në tratativa me shtete të tjera.

Një delegacion i Lidhjes Shqiptare i kryesuar nga Abdyl Frashëri, në muajt prill-qershor të vitit 1879 vizitoi kryeqytetet e fuqive pjesëmarrëse të Kongresit të Berlinit, si edhe Stambollin, për të transmetuar vendimin e Lidhjes se të gjithë shqiptarët do të luftonin në rast se Europa do të lejonte aneksimin e pjesëve të vendit të tyre. Në kërkim të zgjidhjeve të përshtatshme ajo do të negocionte për t'u përfshirë në bashkime juridiko-ndërkombëtare me Greqinë, Maqedoninë etj. Edhe pse marrëdhëniet me Greqinë kushtëzoheshin nga fakti se ajo ishte element vendimtar i aksit vertikal veri-jug, serbo-malazez-grek, që përfaqësonte një ndër faktorët gërryes më të fuqishëm ndaj synimeve kombëtare të shqiptarëve, në raportet Shqipëri-Greqi pati edhe zhvillime të tjera interesante.

Drejtuesit kryesorë të Lidhjes në përpjekje për të siguruar tërësinë territoriale të vendit, por edhe për të neutralizuar efektet e politikës ekspansioniste greke nuk ngurruan t'u kërkonin grekëve bashkëpunim. Pati bisedime greko-shqiptare në Janinë dhe Stamboll. Grekët iu ofruan krijimin e një bashkimi real greko-shqiptar, nën shembullin e Austro-Hungarisë. Monarkia do të kishte në krye mbretin e Greqisë si dhe, sipas skemave tradicionale të kësaj forme të bashkimit të shteteve, së paku tre dikastere qendrore të përbashkëta. Por grekët vunë si kusht që territoret e Shqipërisë së Jugut t'i kaloheshin Greqisë. Delegacioni shqiptar përsëriti se shteti i tyre duhet të shtrihej në të gjitha territoret shqiptare, pa përjashtuar edhe atë që grekët e quanin Epir. Grekët nuk pranuan dhe u ngurtësuan në kërkesa ultimative. Në tentativë për kompromis, Abdyl Frashëri propozoi rishqyrtimin e projektit të

mëparshëm të aleancës shqiptaro-greke. Duke lënë pas projektet për bashkimin real shqiptaro-grek, ai u shpreh për krijimin e një principate shqiptare dhe vendosjen e saj nën suzerenitetin e Greqisë. Kjo ide përfaqësonte një përkeqësim relativ të statusit të Shqipërisë në krahasim me projektin e mëparshëm. Motivi që mund ta ketë shtyrë delegacionin shqiptar drejt kësaj zgjidhjeje ka të ngjarë të ishte fakti se zhvillimi normal i vasalitetit, si formë e varësisë juridike, zakonisht ka si perspektivë shkëputjen e vasalit nga suzereni dhe daljen si shtet më vete. Në këtë optikë vasaliteti shqiptar ndaj suzerenitetit grek ishte një gjetje tranzitore, e cila, për momentin, përkonte me interesat thelbësore të shqiptarëve. Ata shpresonin se në këtë mënyrë mund të ecnin drejt pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar, tashmë edhe me një përkrahje ndërkombëtare. Natyrisht edhe grekët kishin projektet e tyre. Sërish bisedimet dështuan. Ato u rimorën në Korfuz, ku pala greke refuzoi nënshkrimin e marrëveshjes.

Demarshet e tjera u ndërmorën me përfaqësuesit grekë, nga të cilët meriton të përmendet ndërhyrja te ambasadori grek në Stamboll, pas Konferencës së Berlinit, në qershor 1880, për çështjen e kufijve greko-turk. Pala shqiptare avancoi si zgjidhje një ndër alternativat që kishte qarkulluar shpesh në ato kohë, themelimin e një bashkimi personal shqiptaro-grek. Bashkimi personal është një formë juridike e njohur nga e drejta ndërkombëtare, e cila, në dallim nga bashkimi real, nënkupton kryesisht vetëm unifikimin e kurorave. Secili prej shteteve ruan individualitetin e vet juridiko-ndërkombëtar. Më konkretisht, Greqia dhe Shqipëria do të kishin organizimin e tyre të veçantë që përfshinte ekzistencën e parlamenteve, qeverive, strukturave të pushtetit gjyqësor, ushtrive, financave etj. Në këtë pikëpamje ideja ishte mjaft interesante për shqiptarët, sepse ata, nëpërmjet një bashkimi gati virtual me Greqinë, do të realizonin shkëputjen nga Perandoria Osmane, krijimin e një vilajeti të vetëm dhe daljen më vonë si njësi e pavarur. Për më tepër, ata do të shfaqeshin tashmë si subjekt më vete i së drejtës ndërkombëtare. Projekti u mirëprit edhe nga disa prej Fuqive të Mëdha, si: Franca, Italia, Austro-Hungaria dhe Gjermania, të cilat e shihnin bashkimin shqiptaro-grek edhe si një kundërvënie ndaj tentativave ekspansioniste të pakufizuara të sllavëve drejt jugut. Por, shumë shpejt ato do të hiqnin dorë nga përkrahja. Megjithatë, projekti i zgjidhjes së konfliktit shqiptaro-grek nëpërmjet bashkimit të të dy popujve do të ridilte sërish në skenë dhe do të rikonfigurohej në një tjetër format. Ishte skicuar krijimi i një konfederate greko-shqiptare. Autor i saj ishte Charles Dilke, nënsekretar shteti britanik.

Teorikisht edhe konfederata është një formë juridike e bashkimit të shteteve, në të cilën shtetet përbërës mund të bien dakord të krijojnë një organ të përbashkët, në varësi të prioritetit të shpallur. Cedimi i atributëve sovrane të organi qendror i përbashkët, që mund të jetë një këshill, një kongres, një kuvend apo edhe një organ monokratik, konsiderohet i papërfillshëm. Anëtarët

e konfederatës vazhdojnë të ruajnë individualitetin dhe personalitetin e vet juridik duke dalë secili si subjekt më vete i së drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, marrëveshja me grekët ishte e pamundur, sepse, siç thoshte Abdyl Frashëri, ata nuk duan të njohin të drejtat tona; ata duan njerëz të nënshtruar dhe jo të barabartë me ta. Me këtë propozim, që ishte i fundit nga pala shqiptare, do të mbyllej cikli i ofertave reciproke greko-shqiptare, për hyrje në bashkime juridiko-ndërkombëtare, sistematikisht të dështuara. Shkakun do ta përmblihte në mënyrë tepër koncize konsulli grek në Shkodër, i cili thoshte se “Shqiptarët kanë një pasion të pashtershëm për përmbysjen e robërisë dhe për një shtet në të cilin të qeverisin vetë”.

Abdyl Frashëri, i deziluzionuar nga dështimet e përsëritura në negociatat me Greqinë, do ta shtrinte idenë e bashkimit edhe përtej lidhjeve bilaterale. Ai nuk do ta konsideronte të papranueshme idenë e përfshirjes së Shqipërisë në çdo formë organizative konfederatave që mund të krijohej në Ballkan. Për shqiptarët, thoshte ai, duhet të adoptohej një organizim politiko-administrativ evropian i mbështetur mbi ligje evropiane. Në këtë kuadër dhe për këto arsye, më 3 tetor 1879, Kuvendi i Komitetit të Lidhjes Shqiptare në Prizren, në vazhdim të përpjekjeve për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme juridike, nëpërmjet një peticioni drejtuar Sulltanit propozonte krijimin e një *Principate të lirë dhe të pavarur* ose i një *Republike të Shqipërisë dhe të Rumelisë (Maqedonisë) me Manastirin si kryeqytet*.

Rikthehet sërish ideja e bashkimit të një shteti dualist në trajtën e një bashkimi, por tashmë shqiptaro-maqedonas, me një princ të përbashkët në krye të tij. Sikurse pritej, propozimi nuk mund të pranohej nga Sulltani dhe Lidhja do të vazhdonte projektet e saj të organizimit dhe konsolidimit të strukturave shtetërore, pa u ndalur nga përpjekjet për sigurimin e njohjes ndërkombëtare dhe gjetjen e aleatëve evropianë.

